



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / OPŠTINA MUNICIPAL ASSEMBLY
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 299 Nr. i Çeq./Bratë/No. pë 04

Data/Datum/Date 30/03/2022

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja s) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.03.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit ad hoc për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkuruar për Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe

1. Me këtë vendim **caktohet** komisioni ad hoc për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkuruar për Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, ku 2 (dy) anëtarë do t'i zgjedh Kuvendi i Komunës ndërsa 3 (tre) anëtarë do të jenë nga fshati, si në vijim:
 - 2.1. Lirigzon Kastrati, anëtar i Kuvendit i Komunës
 - 2.2. Leonard Morina, anëtar i Kuvendit i Komunës
 - 2.3. Dragana Shavelic, anëtar i fshatit
 - 2.4. Ana Maniteshevic, anëtar i fshatit
 - 2.5. Bojan lukic, anëtar i fshatit
3. Detyrat e komisionit ad hoc sipas Ligjit Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, janë:
 - 3.1. Të verifikoj a është bërë aplikimi nga kandidatët brenda afatit kohor;
 - 3.2. Të verifikoj a i plotësojnë kandidatët kriteret e seleksionimit;
 - 3.3. Të informoj kandidatët për pranimin apo mospranimin të tyre sipas kriterëve;
 - 3.4. Të dërgoj listën e përzgjedhur dhe të merituar të kandidatëve për aprovim në Kuvendin Komunal.
4. Komisioni ad hoc ka për obligim që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së kalimit të afatit për aplikim të zgjedh kandidatët që kanë konkuruar për anëtar të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.
5. Komisioni ad hoc do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë një afat të përcaktuar ligjor.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Kryesuesi i Kuvendit.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit ad hoc,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.299/22
Datë:30.03.2022

